



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 921 Dt. 19 / 04 / 2024

Në mbledhjen e njëmbëdhjetë (XI) të mbajtur më datë 17.04.2024, Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet vendimi i Komisionit të Ankesave të Senatit të UKZ-së, Ref.nr. 05/880 të dt. 08.04.2024, për refuzimin e ankesës së kandidatit Leotrim Musolli për angazhim në Fakultetin Juridik në Fushën Civile dhe për shfuqizimin e vendimit të Senatit.

A r s y e t i m

Senati i Universitetit në mbledhjen e njëmbëdhjetë të mbajtur më datë 17.04.2024, ka shqyrtuar vendimin e komisionit të ankesave Ref.nr. 05/880 të dt. 08.04.2024, të cilin vendim e ka miratuar pasi që komisioni konstaton se pas shqyrtimit të ankesës së kandidatit Leotrim Musolli, dëgjimit të audio incizimeve të Senatit të mbledhjes së X të mbajtur më 22.02.2024 që i referohet rastit në fjalë, si dhe vendimit të Senatit Ref. nr. 01/430 të datës 23/02/2024, konstaton se nuk ka pasur shkelje nga ana e Senatit dhe me propozimin që raporti i komisionit recensues nga Fusha Juridike Civile për Asistent Ref. nr. 05/319 të datës 08/02/2024, të kthehet në piken zero për të tre kandidatët ku propozohet që të formohet një komision i ri dhe nëse nuk ka profesor të fushës së njëjtë në UKZ të merren profesor nga Universitetet e tjera.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa në nivel të Universitetit meqë vendimi i Senatit të Universitetit është përfundimtar.

Kryesuesi i Senatit

Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor



Vendimi i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Sekretarit të Përgjithshëm
3. Fakultetit Juridik
4. Sekretarit të njësisë akademike
5. Zyrës për çështje akademike
6. Arkivit